



## Fëmija ynë shkon në kopësht

Të ndëruar prindër

Që të mund të pergaditeni mirë me fëmijën tuaj, gjeni më tutje informacione të rëndesishme. Ju dëshirojmë juve dhe fëmijës tuaj një perjetim dhe kohë të bukur në kopësht

**Detyrat e kopshtit** Në kopësht mësohet shumë nëpërmjet lojrave. Loja është forma e jetës dhe e të nxënit në kopështin e fëmijëve. Në lojë fëmija mund të shpaloset, të mbledhë përvoja të shumëanëshme dhe të integrohet në një komunitet. Me ndihmën e mjeteve krijuese, edukatorët e kopshteve i mbështesin fëmijët në procesin e tyre të zhvillimit dhe të të nxënit dhe i nxisin ata të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme. Kopshti i fëmijëve zgjat dy vjet. Ndjekja e tij është e detyrueshme dhe pa pagesë.

Gjat arsimimit në klasë perkohësisht do të perkujdeset edhe pedagogja dhe mesuasja e çerdhes së vitit dytë për ikurajimin e fëmijëve

**Orari** (viti I = Fëmijët në vitin e parë të kopështit)

	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
Orari i pritjes 8.00 - 8.20	Të gjithë fëmijët	Të gjithë fëmijët	Viti II-të	Të gjithë fëmijët	Të gjithë fëmijët
Orari i qëndrimit 8.20 – 11.50					
Largimi 11.50 – 12.00					
Orari i pritjes 13.20 – 13.30		Viti i I-të		Viti i II-të	
Orari i qëndrimit 13.30 – 15.00					
Largimi 15.00 – 15.05					

Orari i pritjes (8.00 – 8.20 dhe 13.20 – 13.30) do të thotë që fëmija juaj gjatë kësaj kohe mund të vijë në kopësht dhe pritët nga edukatori. Për sigurinë e fëmijës suaj, ju lutemi që mos ta sillni më shpejt atë në kopësht. Fëmijët, të cilët mbërrijnë më shpejt, nuk do të jenë të mbikqyur.

Fëmijët, të cilët mbërrijnë më vonë se ora 8.20 dhe 13.30, ndërpresin mësimin e nisur ose ndoshta do të qëndrojnë para derës së mbyllur.


















**Pushimet dhe mungesat:** Rregullorja e pushimeve dhe e mungesave është e njëjtë me atë të shkollës Obersiggenthal. Si prindër jeni të detyruar që të arsyetoni ndaj edukatorit çdo mungesë të fëmijës suaj në mësim.

**Ndarja në klasa:** Në komunën Obersiggenthal janë në dispozicion 10 sektorë për ndarje në klasa. Drejtoria e shkollës i ndan fëmijët në klasa deri në fillim të prillit. Për këtë ajo zbaton kërkesat e Departamentit të Kantonit të Aargaut për Arsim, Kulturë dhe Sport (BKS). Dëshirat e ndryshme të prindërve nuk mund të merren gjithmonë parasysh.

**Njoffime:** Deri në Prill fëmija juaj do të jetë caktuar në një kopësht. Nga edukatori i kopështit do të merrni më pas një ftesë personale për një vizitë në kopësht, së bashku me fëmijën tuaj. Edukatori i fëmijës suaj është në dispozicionin tuaj për pyetje individuale. Për sa është e mundur shfrytëzoni për këtë kohë jashtë mësimin. Edukatori do të flasë me kënaqësi me ju rreth zhvillimit të fëmijës suaj dhe do t'ju tregojë se si ai mund të mbështetet dhe shoqërohet në procesin e tij personal të të nxënit. Drejtoria e shkollës: Eprori i edukatorëve është drejtuësja e kopështit. Ajo është në dispozicionin tuaj për takime pasi të keni njoffuar më parë me telefon. Adresën e gjeni në pjesën e pasme të kalendarit të pushimeve ose në adresën e internetit: [www.schule-obersiggenthal.ch/kindergarten](http://www.schule-obersiggenthal.ch/kindergarten).



## Përgatitje për një fillim të mirë të kopështit

		<p>Fëmija është në mëngjes i zgjuar dhe i kthjellët. Prindërit përkujdesen që fëmijet të bëjnë gjum të mjaftueshëm 10-12 orë. Të hanë mëngjes për më shumë energji</p>
		<p>Fëmija mund të shkojë në kopësht vetë apo me percjellje në fillim.</p>
		<p>Fëmija mund të vesh dhe zhvesh rrobat dhe këpucat e veta vetë</p>
		<p>Fëmija mund të rrijë pa familjar 4 orë në kopësht.</p>
		<p>Fëmija ka kontakt me njerëz tjerë jashtë familjarëve (psh në park lojërash) Silltet me rrespekt ndaj personave tjerë.</p>
    	<p>Fëmija nuk mban pelena Fëmija shkon vetë në WC Mund të fshihet vetë. Shpërlan WC pa ndihmë. Lan duart vetë. Fëmija mund ta pastroj vetë hunden.</p>	
	<p>Mëngjesin e sjellur mund ta hajë vetë.</p>	
		<p>Fëmija din të përdorë ngjyrat, gërshtëret, traken dhe ngjitësin.</p>

## Këshillë

Mos hezitoni për pyetje lidhje me temat në vendet perkatëse tek specialistet të kontaktoni për këshilla perkatëse.

- **Mjekja/Mjeku i fëmijëve**
- **Nënë-baba kshillim Bezirk Baden** (Kshilla të mira dhe pa pagesë për prindër apo kujdestar me fëmijë nga 0 – 5 Vjeçë) [www.mvb-baden.ch](http://www.mvb-baden.ch)
- **Stiftung Netz** (Pyetje për zhvillim / edukim i hershem pedagogjik/ Logopedi për fillëstar) [www.stiftungnetz.ch](http://www.stiftungnetz.ch)
- **BZBplus Baden** (Këshilla dhe percjellje për vitet e fillëstare) [www.bzbplus.ch](http://www.bzbplus.ch)